



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.627/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit VBH Kosovo LLC me seli në Drenas, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Veton Rrustemi avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Drenasit, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditues të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.441/23 të datës 07.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditurës Komuna e Drenasit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.441/23 i datës 07.02.2024, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.441/23 të datës 07.02.2024, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit VBH Kosovo LLC me seli në Drenas, Anulohet vendimi nr.01-431/02-45913 dt.12.09.2023 i nxjerr nga Komisioni për Ankesa ndaj taksës komunale pranë të paditurit Komuna e Drenasit, II. Ndryshohet pika 1 e aktvendimit 05 nr.431/01-27654 I dt.09.06.2023 i nxjerr nga i padituri Komuna e Drenasit-Drejtorati per Zhvillimin Ekonomik, ashtu që: a) mbetet ne fuqi taksa komunale e caktuar në shumën prej 250€ për vitin fiskal 2023 për VBH Kosovo LLC, b) Anulohet pjesa e konstatimit lidhur me borxhin total në shumën prej 3,550.00€, III. Ky Aktgjykim e zëvendëson aktin e ndryshuar dhe ka karakter detyrues, IV. Shtyrja e ekzekutimit të aktvendimit 05.nr.431/01-27654 dt.09.06.2023 sipas aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.441/23 I dt.11.10.2023, mbetet në fuqi deri ne plotfuqishmërin e ketij aktgjykimi, IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet në tersi si e bazuar ankesa e paditurës, të Priset aktgjykimi Aktgjykimi i Gjykatës

Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.441/23 i datës 07.02.2024, ashtu që vendimet e paditurës të vërtetohen

Në përgjigjen në ankesë i autorizuari i paditësit kundërshton pretendimet ankimore te paditurës, duke deklaruar se e paditura gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale bazuar në Rregulloren komunale. I propozon gjykatës së shkallës së dytë që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.441/23 i datës 07.02.2024.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjyqimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative e paditura me vendimin përfundimtar 01.431/01-45913 datës 12.09.2023, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit VBH Kosovo LLC me seli në Parku i Biznesit me numër unik 810326456 me ushtrimin e veprimtarisë brenda territorit të Komunës së Drenasit,

Paditësi VBH Kosovo LLC me seli në Parku i Biznesit, ka ushtruar padi në gjykatë duke inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Komuna e Drenasit, respektivisht ka kundërshtuar vendimet kontestuese te paditurës, me arsyetimin se vendimet e kundërshtuara me padi janë të pa drejta dhe në kundërshtim me ligjin.

Dhoma e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 25.01.2024 (në prani të autorizuarit të paditësit, e në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, neni 41 i LKA-së), pasi vlerësoi vendimet e kundërshtuara dhe pas administrimit të provave, mori aktgjykimin e atakuar me të cilin aprovon pjesërisht kërkesëpadinë paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Në arsyetim të aktgjyqimit gjykata referohet në nenin 26 të Rregullores për Ndryshimin-Plotësimin për Taksa, Tarifa, Ngarkesa, dhe Gjoha nr.12-400-16587 dt.27.05.2020 duke nxjerr konstatimin se e paditura Komuna e Drenasit për çdo subjekt afarist që vepron brenda territorit të saj nxjerr vendim çdo vit kalendarik duke e faturuar vetëm për atë vit fiskal, ashtu që bizneset nuk mund të faturohen për vitet paraprake dhe të bëhet mbledhja e të gjitha borxheve të akumuluar ndërsa vite. Rregullim të njëjtë të faturimit të taksës e kanë parapa edhe rregulloret e mëhershme te kësaj Komune. Gjykata vlerësoi se tarifimi i paditësit për vitin fiskal 2023 ishte bërë në përputhje të plotë me dispozitat e lartcekura per tarifimin e bizneseve për ushtrimin e veprimtarisë brenda territorit të Komunës së Drenasit ndërsa për shkak se e njëjta është dashur të nxjerr akte administrative të veçanta për qdo vit fiskal, i padituri nuk është dashur që të bëjë përlllogaritjen e borxhit total për periudhat kohore që paditësi nuk ka bërë pagesën e taksës. Veprimet e të paditurit janë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë pasi që paditësi pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Ndryshimin-Plotësimin për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nr.12-400-16587 dt.27.05.2020 ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Rregullorja në fjalë, dhe ka bërë pagesën e taksës komunale për vitin fiskal 2022 dhe 2023, ndërsa veprimi i të paditurit që të

faturorj borxhin total pe vitet 2013 deri 2023 ka qenë në kundërshtim me vendimet te Qeveris për lirim nga pagesa e taksës.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejt ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke lënë në fuqi vetëm taksën komunale në shumën prej 250.00€ për vitin fiskal 2023. Në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar. gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me shkeljet ligjore që ka zbatuar e paditura me rastin e vendimmarrjes në procedurën administrative kur paditësit i ka caktuar përveç taksës komunale për vitin fiskal në shumën prej 250.00€ për vitin fiskal 2023, ndërsa në mënyrë të kundërligjshme ka ngarkuar paditësin me borxhin total në shumën prej 3,550.00€ për veprimtarin që e ushtron në territorin e Komunës së Drenasit.

Kolegji vlerësoi se me të drejt gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se Rregulloret Komunale të miratuara nga vet e paditura 2018, 2019 kanë rregulluar faturimin e taksave komunale në baza vjetore, përderisa e paditura me vendimin e parë 05.nr.431/01-27654 dt.09.06.2023 i cakton paditësit taksën komunale për vitin fiskal 2023, dhe për borxhin total sipas gjendjes së kartelës, për veprimtarin që e ushtron në territorin e Komunës së Drenasit. Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur me aktgjykimin e ankimuar ka anuluar pjesën e vendimit kontestues të paditurës përkatësisht ka anuluar pjesën e konstatimit lidhur me borxhin total në shumën prej 3,550.00€, ndaj paditësit, për shkak të mos zbatimit të drejt të ligjit.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike sepse pjese e vendimit kontestues është vetëm evidentuar edhe borgji per vitet e mëparshme fiskale, se nuk janë dhënë arsye të qarta dhe të pranueshme sa i përket bazës ligjore, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në ligj, sepse gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, dhe vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve kontestuese te paditurës, me të drejt ka aprovuar pjesërisht padinë e paditësit, duke anuluar si të kundërligjshme borxhin e caktuar ndaj paditësit në shumën prej 3,550.00€ si borxh total i akumuluar para vitit 2023. E paditura përkundrejt Rregulloreve komunale të miratuara çdo vite për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha, për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznese, dhe autorizimeve ligjore për caktimin e taksave komunale vjetore, me vendimet kontestuese e paditura në mënyrë të kundërligjshme e ngarkon paditësin edhe me taksën për vitet paraprake.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase është nuk cënuar ligji në dëm të paditurës, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, gjeti se Dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.627/24 datë 29.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha